**VENDIM**
**Nr.592, datë 25.5.2009**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË DISA MJEDISEVE AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të disa mjediseve, konkretisht, katin e pestë teknik të ndërtesës, në adresën "Pallati nr.4, rruga "Skënderbej", Tiranë, në administrim të Drejtorisë së Shërbimit Diplomatik, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për ndërhyrjet në konstruksion ose për përshtatjen e mjediseve, të dhëna në përdorim, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve duhet të marrë detyrimisht miratimin e administratorit të pasurisë.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Drejtoria e Shërbimit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

# PLANIMETRIA E KATIT TE IV DHE

Shkalla 1 : 125



SIP. ND.= 525.2 m² PER 1 KAT

| | |
|---|---|
| OBJEKTI | GODINA Nr.4 |
| TITULLI I FLETES | PLANIMETRIA E KATIT TE IV DHE V |
| POROSITES | DREJTORIA E SHERBIMIT DIPLOMATIK |
| GRUPI I PUNES | Nr. LIÇENSES |